



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 3903 prot

Ballsh më 2108 / 2025

Nr. 08 datë 21 / 08 / 2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 21 / 08 / 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 28 / 08 / 2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(Guzana Malaj Malaj)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(Klodjan Shehaj)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Nethmi Selaj)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 3903 prot.
/1

Ballsh më 21.08.2025

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkiasë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e **Enjte, datë 28 .08.2025, ora 10:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.07.2025.
3. **Projektvendim Nr.32:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.33:** Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kopetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA).

Mbledhja e komisioneve: për pikat 3,4 të rendit të ditës Komisioni Juridik dhe për pikën 4 Komisioni i Ekonomisë.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

